



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**VENDIM QARKULLUES**

**Nr. 39, datë 29.12.2022**

**PËR**  
**MIRATIMIN E BUXHETIT**  
**TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**PËR VITIN 2023**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 44, pika 1, shkronja “a”, të nenit 51, pika 4, të nenit 52, pika 1, shkronja “gj”, të nenit 53, pika 5, shkronja “f” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 18, pika 1, shkronja “b” të Rregullores “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 34, datë 27.11.2020, si dhe të nenit 10, pika 6 dhe të nenit 18 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2023, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për dërgimin në Autoritet Mbikëqyrës të njoftimit për miratimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2023, si dhe një kopje të tij.
3. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.





4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

